



Primitur / Dorezuar Priljevend / Protokoll Received / Delivery	22.02	702	3	viti god year
Organ / Njësia Organ / Jedinstvo Org / Unit	Nr. Prot Br. Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity	
SKOVESHOK	1985/2023		112	



Republika e Kosovës Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.113/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Jeton Koca-kryetar, Ardita Haxhnikaj-Demi dhe Eshref Shabani-anëtarë, me Ardita Perçuku-Shyti-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, në çështjen administrative sipas ankesës me numër A.nr.113/2023 të datës 23.01.2023 të parashtruar nga ankuesja kundër organit të punësimit/Komuna e Gjakovës, në çështjen juridike-administrative "shkelje e të drejtës në pagë", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafin 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datën 22.02.2023, mori këtë:

V E N D I M

I. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil i Kosovës, **Shpallet jo kompetent** për të vendosur për ankesën me numër A.nr.113/2023 të datës 23.01.2023, të parashtruar nga ankuesja

II. Lënda i dërgohet për shqyrtim dhe vendosje organit kompetent/Komisionit për Ankesa në Komunën e Gjakovës.

A r s y e t i m

Ankuesja e punësuar në pozitën e punës "Zyrtar për Telefoni" në kuadër të Drejtorisë për Mbrojtje dhe Shpëtim pranë Komunës së Gjakovës, më datën 23.01.2023 ka parashtruar ankesën me numër të protokollit 666/2023 të regjistruar nën shenjën A.nr.113/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër përgjigjes së datës 16.01.2023 të Menaxherit të Zyrës së Personelit në Komunën e Gjakovës lidhur me refuzimin e kërkesës së ankueses për harmonizim të koeficientit të pagës nga pesë (5) në gjashtë (6).

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave duke u bazuar në Vendimin Nr.01-112/02-33845 të datës 05.11.2021 të lëshuar nga Menaxheri i Burimeve Njerëzore të Komunës së


Gjakovës, konstatoi se ankuesja është zyrtare publike me status të *Nëpunësit administrativo-teknik dhe mbështetës* të përcaktuar me nenin 2 paragrafin 6 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë.

Andaj, duke u bazuar në dispozitat e nenit 6 paragrafit 1 nën paragrafit 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ku përcaktohet se Këshilli është kompetent që të shqyrtoj dhe të merr vendime vetëm për ankesat e nëpunësve civil dhe kandidatëve për praninë në Shërbimin Civil të Kosovës, dhe meqenëse ankuesja nuk e ka statusin e nëpunësit civil, Kolegji i Këshillit konstaton se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil i Kosovës **nuk është kompetent** për të vendosur për ankesën me numër A.nr.113/2023 të datës 23.01.2023, të parashtruar nga ankuesja Vera Shala.

Marrë parasysh konstatimin si më lartë se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës nuk ka juridiksion për të vendosur lidhur me ankesën me numër A.nr.113/2023 të datës 23.01.2023 dhe meqenëse nga shkresat e lëndës vërehet se ankuesja nuk ka shfrytëzuar mjetet juridike në procedurë administrative pranë organit punëdhënës, Kolegji i Këshillit duke u bazuar në nenin 24 paragrafi 4 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, nenin 75 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, si dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr.06/L048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, vendosi që të shpallet jo kompetent për të vendosur lidhur me ankesën A.nr.113/2023 të datës 23.01.2023 dhe për bartjen e lëndës të organi kompetent, në këtë rast Komisionit për Ankesa të Komunës së Gjakovës.

Këshillë juridike: Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit. Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.113/2023.

Ardita Perçuku-SHYTI

Procesmbajtëse



Vendimi i dërgohet:

- Ankueses;
- Kryetarit të Komunës së Gjakovës;
- Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Gjakovës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

